




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opštine Orahovac / Municipality of Rahovec



Nr. I prot. 2834 Më 30.08.2024
Br. prot. Dt. 2024



Mbështetur në Ligjin Vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, neni 14, pika 14.2, Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Statutit të komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, Neni 18 pika 3 të Rregullores për Taksa komunale 01/80, vendimit të kuvendit komunal të Rahovecit Nr. 01/206 të datës: 28.03.2024 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës së Rahovecit, komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i caktuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit nr.01/207, të DT. 28.03.2024, shpall këtë;

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

1. Njoftimi publik për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:

1.1 Prona e paluajtshme komunale në Bërnjakë, ngastra kadastrale nr. P-71510006-00301-3, zona kadastrale në Bërnjak, në vendin e quajtur e quajtur grlo-vrnjaqka, në sipërfaqe të prej 486 m² (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë metra katrorë) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1500 m² (njëmijë e pesëqind metra katror) duke përfshirë edhe objektin, e evidentuar në posedim të Komuna e Rahovecit.

Njoftimi për ankand publik përfshinë:

1.1. Çmimin fillestar i pronës komunale duke përfshirë edhe objektin të cekur në pikën 1.1 do të jetë 1€ (një euro) në muaj.

1.2. Afati i dhënies në shfrytëzim i pronës:

Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës – do të jetë afatshkurtër prej pesë (5) vitesh.

1.3. Qëllim i dhënies në shfrytëzim:

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të komunës është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale publike, për zhvillimin e aktiviteteve të shoqërisë civile me qëllim të promovimit të turizmit të Komunës së Rahovecit, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

2.1. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronës për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara. Ofertat dorëzohen të mbyllura nëpërmjet zyrës së prokurimit në Rahovec nga data: **30.08. deri me datë: 13.09.2024**, nga ora **09:00 deri në ora 15:00**.

Vendi, koha ku do të mbahet ankandi publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal me dt. **16.09.2024** në fillim në ora **13:30**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

2.2. Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim:

- 2.2.1. Pronat nuk mund të përdoren për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar me ankand publik dhe e njëjta nuk mund të bartet ne personin e tretë.

3. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- a. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së.

4. Kriteret për dhënien në shfrytëzim të shtëpisë së verës:

- Përmes shtëpisë së verës të mundësohet promovimi i produkteve të rrushit, produkteve të alkoolit: verërave, rakisë dhe produkteve tjera.
- Të respektoj rregulloren e brendshme për orar të punës dhe ligjeve në fuqi, po ashtu me kërkesë të Komunës së Rahovecit në organizime të aktiviteteve dhe nevojave të Komunës të jetë në dispozicion.
- Të merret me aktivitete, promovimin e turizmit në Komunën e Rahovecit.

- Projektin investiv, të gjitha investimet të jenë në harmoni me historikun, kulturën dhe traditën e Komunës së Rahovecit.
- OJQ të jetë e regjistruar para publikimit të thirrjes.

4.1. Mbajtja e aktiviteteve të ndryshme në periudha 3 (tre) mujore si:

- Dita ndërkombëtare e verërave -të mbahet panairi i verërave
- Organizimi i festivalit të prodhimeve bujqësore sezonale dhe produkteve artizanale në periudhën Prill-Qershor
- Ekspozita kulturore dhe historike e Rahovecit në periudhën korrik-shtator
- Panairi i verërave dhe produkteve të alkoolit për fund vit.

4.1. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

- 4.1.1. Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik,
- 4.1.2. Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,
- 4.1.3. Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,
- 4.1.4. Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- 4.1.5. Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmojnë si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

5. Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës;

5.1. Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

5.2. Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:

- 5.2.1. Një kopje të shpalljes së ankandit publik;
- 5.2.2. Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
- 5.2.3. Rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e fituesit;
- 5.2.4. Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur;
- 5.2.5. Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.

6. Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.
7. **Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.**
8. Nëse Komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
9. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh punc nga data e miratimit të ofertës nga ana e Komisionit vlerësues.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik bëhet në formë fizike në zyrën e prokurimit në Rahovec.

Rahovec, 30.8. 2024